



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËRKORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI – CORRUPTION AGENCY



RAPORT I PROGRESIT MBI PUNËN E AGJENSIONIT PËR GJASHTË MUAJIT E PARË TË VITIT 2007

(janar -qershor 2007)

Tabela e permbajtjes

I.	HYRJE	3
II.	DEPARTAMENTI PER STRATEGJINE ANTI-KORRUPSION DHE HETIMET ADMINISTRATIVE.....	3
i.	Hetimet Administrative	4
ii.	Iniciativat Legjislative	6
iii.	Pjesëmarrja në aktivitete te ndryshme.....	7
III.	DEPARTAMENTI I PARANDALIMIT TE KORRUPSIONIT.....	8
i.	Mbikeqyrja e Pasurive.....	8
ii.	Kontrolli i Formularëve te Deklarimin te Pasurive	10
iii.	Konflikti i Interesit	11
iv.	Pranimi i Dhuratave.....	12
v.	Pjesëmarrja në takime, seminare, vizitat zyrtare dhe trajnime te ndryshme	12
IV.	DEPARTAMENTI I SHERBIMEVE ADMINISTRATIVE	12
i.	Buxheti 6 mujor per vitin 2007	13
ii.	Burimet Njerezore.....	15
V.	ZYRA PER MARREDHENIE ME PUBLIKUN.....	18
i.	Takime me gazetarë dhe qytetarë.....	18
ii.	Faqja e re zyrtare e internetit.....	18
iii.	Deklaratat per shtyp	19
iv.	Monitorimi i mediave ne periudhen janar - qershor '07	19
v.	Aktivite dhe bashkëpunimi.....	21
VI.	PROBLEMET E NDESHURA.....	21
VII.	SFIDAT E SË ARDHMES.....	22
VIII.	ANEKS I – ORGANIGRAMA E PERDITESUAR E AGJENSIONIT	24

I. HYRJE

Ky raport pasqyron punën gjashtë mujore të AKK-së, brenda periudhës nga 17 Janar – 17 Korrik 2007. Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga AKK gjatë kësaj periudhe, të cilat janë paraqitur sipas fushave që mbulon secili Departament.

Ky është raportimi i dytë përpara Keshillit të Agjencionit, raporti i parë është bërë në Dhjetor 2006, atëherë kur Agjensioni kishte vetëm pak muaj që ishte krijuar si institucion dhe ende nuk ishte vendosur në një godinë të veten e po përpiquej të krijonte një strukturë paraprake për funksionimin e institucionit. Raporti i dytë tenton të paraqesë anetareve të Keshillit një pamje të qartë të iniciativave, aktiviteteve dhe punës së përditshme sikunder dhe problemeve e pengesave që Agjensioni ka hasur në 6 muaj të parë të vitit 2007.

Ky gjashtëmujor ka qenë pa dyshim një fazë e mbushur me sfida. AKK ka shpallur funksionalitetin më 12 Shkurt 2007 dhe gjithë kjo periudhë ka qenë e mbushur me aktivitete të shumta drejt realizimit të misionit të përcaktuar në kornizën ligjore. Me buxhet të cinguar, me personel të ri dhe pa përvojë pune në këtë fushë, me strukturë personeli të pamjaftueshme, me përkrahje jo adekuate Institucionale, të gjitha këto parakushte për fillimin dhe vazhdimin normal të punës, gjithsesi Agjensioni është përpjekur që rezultatet e këtyre gjashtë muajve të jenë të një niveli të kënaqshëm.

Në këtë raport do të gjeni përshkrimin dhe vlerësimin për korrupsionin në Kosovë, si dhe masat e ndërmarra nga AKK në parandalimin apo eliminimin e shkaqeve të korrupsionit dhe ngritjen e vetëdijes qytetare mbi këtë fenomen të demshëm për shoqërinë kosovare.

Aktivitetet e AKK-së kanë qenë të drejtuara në këto drejtime:

- Zbatimi i ligjit;
- Parandalimi dhe eliminimi i shkaqeve të korrupsionit; dhe
- Edukimi, ngritja e vetëdijes qytetare.

Në baze të zbatimit të tre shtyllave të lartpërmendura do të shtjellohen dhe iniciativat dhe aktivitetet e ndërmarra nga strukturat e Agjencionit.

II. DEPARTAMENTI PËR STRATEGJINË ANTI-KORRUPSION DHE HETIMET ADMINISTRATIVE

Departamenti për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative gjatë periudhës 6 mujore ka zhvilluar një aktivitet tejet të ngjeshur në drejtim të zbatimit të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin Kundër Korrupsionit, Rregullat Procedurale të Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit, Vendimit për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të AKK-së si dhe të akteve e tjera të brendshme.

Departamenti është i organizuar në dy divizione, ato të Strategjisë Anti-korrupsion dhe Edukimit të Publikut si dhe Divizioni për Hetime Administrative dhe Ceshtje Ligjore. Aktivitetet që vijojnë me poshtë janë pasqyrim i punës së kombinuar midis dy divizioneve meqenëse ato nuk janë ende në kapacitetin e tyre të plote me stafin e nevojshëm.

Në këtë drejtim aktiviteti 6 mujor i Departamentit ka qenë i shtrirë në dy rrafsh kryesore:

- Në rrafshin e hetimit të rasteve të korrupsionit; dhe
- Në rrafshin e legjislacionit.

i. Hetimet Administrative

Kjo pjese paraqet nje pasqyre te punes se kryer deri tani me ne lidhje me rastet e paraqitura ne Agjension mbi kallëzimet per veprimet korruptive, procesin e hetimit te tyre si dhe procedimin e metejshem ne prokuroritë publike kompetente dhe organet policore.

Rastet e paraqitura në periudhën Janar – Korrik 2007

Lidhur me gjendjen e korrupsionit në Kosovë dhe shtrirjen e tij në institucionet e Kosovës, në bazë të rasteve të paraqitura para Agjensionit Kosovar Kundër Korrupsionit kemi situatën si në vijim:

- Sa i përket rasteve të paraqitura për vitin 2007, që përfshin periudhën kohore nga fillimi i vitit deri me momentin e raportimit, janë paraqitur gjithsej 74 raste të dyshimit për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës.
- Rastet te cilat i referohen Qeverisë së Kosovës (ketu përfshihen edhe ministrите) arrijne numrin 14 ose e shprehur ndryshe ne përqindje ne krahasim me totalin e rasteve, 18.91% të tyre.
- Ndaj pushtetit lokal ku këtu hyjnë të gjitha Kuvendet Komunale janë paraqitur 14 raste të dyshuara, shprehur në përqindje kjo shifër është 18.91% e rasteve.
- Ndaj institucioneve tjera publike (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) janë paraqitur 24 raste ose 32.43% të rasteve.
- Ndaj Gjykatave janë paraqitur 21 raste ose shprehur në përqindje 28.38% të rasteve.
- Ndaj Prokurorive Publike eshte paraqitur vetem 1 rast i dyshuar për veprime korruptive, kjo shprehur në përqindje eshte 1.35 %, ndërsa ndaj Kuvendit të Kosovës nuk është paraqitur asnjë rast.

Te dhenat e lartpermendura jane te paraqitura ne përqindje ne diagramen e mëposhtme, Figura 1:




Fig.1. Pasqyrë e rasteve të paraqitura në Agjension në periudhën Janar – Korrik 2007

Rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore

Fillimisht duhet përmendur fakti se të gjitha rastet e paraqitura në Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsionit janë shqyrtuar paraprakisht, janë zhvilluar hetime administrative për secilin prej tyre dhe për shkak të mungesës së fakteve apo kur rastet kanë qene të pabazuara janë mbyllur 28 prej rasteve të paraqitura.

Ndërsa nga rastet për të cilat është konstatuar se ka prova të mjaftueshme dhe se Agjensioni ka kompetencën për të kryer hetimeve administrative, vetëm gjatë 6 muajve të parë të vitit 2007 kemi pasur 30 raste të dyshuara për veprime korruptive të cilat pasi janë paraprakisht shqyrtuar dhe hetuar konform legjislacionit në fuqi janë proceduar në Prokuroritë Publike të Qarkut kompetente apo në organet policore.

Nga rastet e dërguara në Prokurori për procedim penal shihet se dominojnë rastet e paraqitura kundër institucioneve tjera (Aeroportit Ndërkombëtar i Prishtinës, Postes dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Korporates Elektroenergjetike të Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut, Agjencisë Kosovare e Mirëbesimit), ku aktualisht janë 10 raste të proceduara, apo shprehur në përqindje perben 33.33 %.

Përsa i përket hetimeve mbi rastet e dyshuara për veprime korruptive në gjykata, nga këto janë dërguar në Prokurori për procedim 8 raste, shprehur në përqindje 26.66%.

Në lidhje me rastet e dyshuara për veprime korruptive në Qeverinë e Kosovës (këtu përfshihen edhe ministrinë) der tani janë kryer hetimet administrative dhe dërguar në Prokurori për procedim 6 raste, shprehur në përqindje kjo është 20.00 % nga totali i rasteve të proceduara.

Për rastet mbi çështje korruptive në nivelin lokal pas hetimeve të kryera i janë percjelle Prokurorisë Publike 6 raste ose e thënë ndryshe 20.00 %.

Figura 2 në vijim tregon rastet e dërguara në prokurori në nivel përqindjesh:




Fig.2. Pasqyrë e rasteve të proceduara në Prokuroritë Publike kompetente ne periudhen Janar – Korrik 2007

Në përputhje më legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, natyra e rasteve te paraqitura sipas veprave penale është si me poshte vijon:

Shpërdorim i detyrës zyrtare – janë proceduar tek organet kompetente 7 raste;

Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare – janë proceduar 6 raste;

Marrja e ryshfetit - janë proceduar 7 raste të dyshuara;

Ushtrim i ndikimit – janë proceduar 3 raste të dyshuara për veprime korruptive;

Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore – janë proceduar 4 raste;

Arkëtim dhe pagesa e paligjshme- janë proceduar 2 raste të dyshuara; dhe

Falsifikim i dokumentacionit zyrtar – është proceduar 1 rast i dyshuar.

Mbi 16 rastet e tjera te cilat jane ende në Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsionit janë zhvilluar procedurat e nevojshme hetimore dhe tani janë në fazën e përgatitjes së tyre për procedim të mëtejshem në institucionet kompetente perkatese.

Ofrimi i këshillave ligjore për qytetarët

Gjate kesaj periudhe, Departamenti per Strategjine Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative ka ofruar edhe keshillime ligjore për qytetarët e ndryshëm të cilët i janë drejtuar Agjensionit për paraqitjen e ankesave të tyre. Në ato raste kur Departamenti nuk ka pasur kompetenca per zgjidhjen e tyre, i ka udhëzuar subjektet e ndryshme se ne cilat institucione kompetente duhet te adresojne ankesat e tyre.

ii. Iniciativat Legjislative

Gjithashtu Departamenti gjatë kesaj periudhe ka kryer një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes së akteve të brendshme rregullative për mirefunksionimin e AKK-së. Në këtë drejtim janë përgatitur 20 Propozim – Vendime për nënshkrim nga ana e Drejtorit të AKK-së si dhe është dhënë ndihmë e nevojshme profesionale juridike në përgatitjen e Rregullave Procedurale për Punën e Këshillit të AKK-së dhe në përgatitjen e Rregullave Procedurale të AKK-së. Departamenti ka marrë pjesë dhe në disa mbledhje të Këshillit të AKK-së duke ofruar konsulencën e nevojshme profesionale juridike për shqyrtimin dhe aprovimin e dy Rregullave Procedurale, ato të Këshillit dhe të AKK-së.

Eksperienca me bazen ligjore të funksionimit të AKK-se, Ligji kundër Korrupsionit, ka treguar se ky ligj ka nevojë për një rishikim rigoroz dhe përmirësim të disa aspekteve të tij, Departamenti ka filluar studimin e legjislacionit anti-korrupsion të vendeve të rajonit si dhe vendeve të tjera evropiane të cilat kanë pasur praktika të mira në këto fushe dhe aktualisht janë përgatitur amendamentet e nevojshme të Ligjit. Këto amendamente do të kryhen sipas procedurës së paraparë për shqyrtimin dhe aprovimin e tyre nga Parlamenti i Kosovës.

Departamenti ka marrë pjesë deri tanimë në dy debate publike të iniciuara nga MSHP-ja në lidhje me përgatitjen e Projektligjit për Shërbimin Civil në Kosovë duke dhënë komentet dhe propozimet ligjore të nevojshme në pasurimin e draftit ligjor të propozuar.

Për më tepër ka marrë pjesë në Grupin Punues Qeveritar për përgatitjen e Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Funksionin Publik, projektligj ky i iniciuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, duke dhënë një kontribut të madh profesional në hartimin final të këtij ligji të rëndësishëm në fushën e parandalimit të korrupsionit.

iii. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme

Si rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), Departamenti ka marrë pjesë aktivisht në 10 seminare të organizuara në 10 komuna të Kosovës: Drenas, Gjilan, Istog, Rahovec, Mitrovicë, Suharekë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj dhe Gjakovë. Në këto seminare pjesëmarrësit janë njohur me punën e kryer për Strategjinë Kundër Korrupsionit, Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit, Ligjin Kundër Korrupsionit si dhe mandatin ligjor e aktivitetet e Agjensionit Kosovar Kundërkorrupsionit. Në kuadër të këtij organizimi, ky aktivitet është prezantuar edhe në dy stacioneve televizive lokale në Mitrovicë dhe në Gjakovë ku para teleshikuesve është prezantuar aktiviteti i AKK-së.

Lista e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar, pjesëmarrjen e Departamentit në disa prej aktivitete të larmishme të zhvilluara gjatë kesaj kohe. Aktivitetet sigurisht që kanë ndihmuar gjerësisht në ngritjen e metejshme të kapacitetit të punonjësve të Departamentit si dhe në përmirësimin e performancës në kryerjen e detyrave që ka Departamenti. Trajnimet e kryera deri në momentin e raportimit mund të gjenden tek tabela e trajnimeve. Në vijim paraqitet pjesëmarrja e Departamentit në disa aktivitete ku Agjensioni ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe aktiv:

- Pjesëmarrja në takimet e standardit "Sundimi i Ligjit" të organizuara nga Ministria e Drejtësisë në të cilat është raportuar gojarisht dhe me shkrim për aktivitetet e AKK-së në drejtim të zbatimit të këtij standardi;

- Pjesëmarrja në Takimin e 12-të të Mekanizmit të Stabilizim Asociimit të organizuar në Prishtinë nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian në të cilin takim u prezantua për aktivitetet, planet për të ardhmen dhe sfidat në realizimin e mandatit ligjor të AKK-së;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- Departamenti ka marre pjesë aktivisht në një seri takimesh zyrtare, seminaresh dhe organizimesh të tjera të ngjashme të organizuara nga institucionet e tjera dhe që si tematikë të tyre kanë pasur luftën kundër korrupsionit.

III. DEPARTAMENTI I PARANDALIMIT TE KORRUPSIONIT

Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar aktivitetin e tij pas shpalljes së funksionalitetit të Agjensionit Kosovar Kundërkorrupsionit, përkatësisht me 12 shkurt 2007.

Gjatë kësaj periudhës kohore, Departamenti duke u bazuar në mandatin që i është dhënë me Ligjin Kundërkorrupsionit (LKK) dhe Rregullave të Brendshme Procedurale të AKK-së dhe Rregullave për Organizimin dhe Sistemizimin e Agjensionit, ka zhvilluar një aktivitet të larmishëm me qëllim realizimin e obligimeve që dalin nga Ligji Kundër Korrupsionit dhe akteve tjera të theksuara më lart.

Duhet theksuar se gjatë realizimit të aktiviteteve të veta Departamenti ka hasur në vështirësi të theksuara që lidhen kryesisht me mungesën e numrin adekuat të punësuarve në këtë departament, meqenëse aktualisht janë vetëm tre të punësuar nga 9 të parashikuar në organigramen e institucionit, mungesa e infrastrukturës paraprake në AKK si dhe pengesat që reflektohen nga mungesa e stimulimit dhe mbështetjes adekuate për angazhimet specifike në drejtim të realizimit të misionit të AKK-së.

Nga aktiviteti i kryer deri tanimë është vërejtur se për një mbarëvajtje dhe konsolidim të AKK-së nevojitet që urgjentisht brenda këtij viti të bëhet plotësimi me zyrtare i Departamenteve kyçe siç është Departamenti në fjalë si dhe mbështetja adekuate financiare për të punësuarit në mënyrë që të ruhen nga largimi kapacitetet ekzistuese dhe njëherazi të bëhet inkurajimi i kuadrove profesionist.

Puna në Departament është e shpërndarë midis Divizionit për Mbiqyrjen e Pasurive dhe Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave dhe Pranimin e Dhuratave.

i. Mbiqyrja e Pasurive

Duke u bazuar në nenin 39 të LKK-së, Agjensioni mbikëqyr pasurinë e personit zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili do të përcaktohet nga Agjensioni.

Duke vepruar konform dispozites ligjore të parashtruar më lart paraprakisht Agjensioni ka përcaktuar Formularin për Deklarimin e Gjendjes së Pasurisë së Personave Zyrtar të Lartë. Sipas dispozitave ligjore të LKK-se, formularët e plotësuar duhet të dorëzohen pranë Agjensionin deri më 31 mars 2007.

Departamenti ka filluar punen me shperndarjen e formulareve tek te gjithe zyrtaret e lartë në institucionet qendrore ne daten 01 mars 2007. Në bazë të listave të cilat janë paraqitur nga institucionet përkatëse, janë evidentuar 732 zyrtar të lartë të cilët janë të obliguar të bëjnë deklarinimin e pasurisë. Brenda afatit ligjor, përkatësisht ne daten 31 mars 2007, këtij obligim i janë përgjigjur vetem 67.07% e zyrtarëve të lartë publik.

Lidhur me gjendjen e këtij procesi ju paraqesim Tabelen A me të dhënat konkrete lidhur me formularët e deklarimit të pasurive ne daten 2 Prill 2007:

Tabela A

Institucionet	Numri i zyrtareve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Numri i zyrtareve që kanë deklaruar pasurinë në afatin ligjor	Përqindja e deklarimit (%)
Kuvendi	123	51	41.4
Presidenca	4	2	50
Qeveria	202	120	59.4
Gjykatat	316	255	80.6
Prokuroria	87	63	72.4
Totali	732	491	67.07

Duke u bazuar në dispozitat perkatese të LKK-së nëse zyrtari i lartë nuk dorëzon informacionin e referuar brenda afateve të përcaktuara në këtë Ligj, Agjensioni nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit.

Bazuar në këtë, Departamenti pas verifikimit të listave të zyrtarëve të cilët nuk kishin dorëzuar formularët, nxorri ne date 11 prill 2007 një paralajmërim dhe vendosi një afat të ri për dorëzimin e formulareve. Afati i ri i vendosur nga AKK përcaktonte daten 4 maj 2007 si afati me i fundit ligjor per dorëzimin e deklarimeve.

Pas përfundimit të afatit të ri në AKK kane dorëzuar deklarimet e tyre gjithsej 94.4% e zyrtarëve të obliguar.

Lidhur me gjendjen e përgjithshme te procesit te deklarimeve te pasurise, Tabela B jep ne menyre te detajuar përqindjet e zyrtareve te deklaruar te ndare ne baze te institucioneve.

Tabela B

Institucionet	Numri i zyrtareve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Pozitat e paplotës uara ¹	Numri i zyrtareve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
Kuvendi	123	1	111	11	90.9

¹ Pozitat në fjalë janë lajmëruar si të paplotësuara ende me zyrtar të lartë publik apo janë në proces të plotësimit.

Presidenca	4		4	0	100
Qeveria	202	4	184	14	92.9
Gjykatat	316		302	14	95.5
Prokuroria	87		86	1	98.8
Totali	732	5	687	40	94.4

Ne rastet kur zyrtari i lartë nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në ligj, Agjensioni ka informuar organin ku zyrtar i lartë ushtron detyrën e tij ose organin përgjegjës për përcaktimin e pagesës së pagës apo shpërblimin e pagës. Paga ose shpërblimi i pagës zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj pas kalimit të afatit të referuar me siper derisa ne Agjensionin Kosovar Kunder Korrupsionit te merret njoftimi se zyrtari i lartë ka dorëzuar informacionin e kërkuar.

Bazuar ne cfare u tha me siper, Departamenti ka informuar ne date 16 maj 2007 te gjitha institucionet në të cilat punojnë zyrtarët të cilët nuk e kishin dorëzuar formularin mbi gjendjen e pasurisë për mos përmbushjen e obligimit ligjor si dhe ia eshte kërkuar institucioneve perkatese të ndërmerren veprimet ndershkuese.

Duhet theksuar se ne periudhen ne vijim ka vazhduar pranimi i formularëve nga zyrtarët e caktuar dhe përqindja e deklarimit ne daten 10 korrik 2007 është gjithsej 97.5% e personave të obliguar.

Gjithashtu ne baze te detyrimit ligjor qe Agjensioni duhet ti paraqesi Keshilli te Agjensionit pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension, pasi ai eshte organi i cili i mbikëqyr keto te fundit, gjate muajit maj, Departamenti ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit nga ana e te punësuarve ne AKK, përkatësisht jane paraqitur deklarimet e 15 zyrtareve para Këshillit të Agjensionit.

Ne kontekstin e mire menaxhimit te Departamentit ne pergjithesi dhe divizioneve te tij ne veçanti, gjate ketyre muajve te fundit eshte punuar intensivisht per konceptimin dhe krijimin e nje bazë të dhënash per deklarimet e pasurive, cfare ka bere te mundur krijimin e dosjeve individuale për të gjithë zyrtarëve të lartë publik në bazë te institucioneve përkatëse dhe sistemin e informacioneve perkatese ne to. Kjo bazë do ti shërbej Departamentit dhe Agjensionit në përgjithësi për kryerjen me efikasitet të aktiviteteve që lidhen me procesin e deklarimit të pasurisë, hetimit të ekzistences të konfliktit të interesave dhe ne kryerjen e detyrave te tjera që dalin nga mandati i AKK-së.

Gjithashtu eshte ne proces edhe konsolidimi i bazës elektronike të të dhënave, e cila me kompletimin e Agjensionit me zyrtarin/en e teknologjisë informative do të arrihet që të modernizohet dhe të freskohet vazhdimisht me të dhëna ne kohe reale.

ii. Kontrolli i Formularëve te Deklarimin te Pasurive


Aktualisht, Departamenti është në proces per shqyrtimin dhe kontrollin e formularëve mbi deklarimin e gjendjes së pasurisë, në kuptim të përmbushjes së rregullt, të plotësimit adekuat dhe ne baze te kërkesave që dalin nga formulari.

Pas kontrollit teknik/logjik shihet se te 365 apo 49% e formularëve ka mungesa në mënyrën e të plotësuarit. Në 232 raste apo 31% të rasteve nuk janë deklaruar të hyrat vjetore. Në 84 raste apo 11% e rasteve nuk

është deklaruar informacioni i nevojshëm rreth pasurisë së paluajtshme, ndërsa në 48 apo 6.5 % të rasteve ka mungesë informacioni rreth parave të gatshme dhe pasurisë së luajtshme.

Tabela C ofron të dhëna në formë grafike lidhur me aspektet e lartpërmenduar:

Tabela C



iii. Konflikti i Interesit

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna nga Ligji Kundër Korrupsionit që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, si dhe duke u bazuar në kapacitete ekzistuese janë ndërmarre veprime të caktuara konform dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit. Ketu duhet pasur parasysh se Departamenti është në procesin e shqyrtimit të formularëve të paraqitur dhe në përfundim të shqyrtimit të tyre pritet të shihet apo përcaktohet ekzistenca apo jo e konfliktit të caktuar të interesit tek zyrtarët e lartë publik.

Deri tani, Agjensioni ka marrë informata të bazuara për ekzistencën e konfliktit të interesit të një zyrtari të lartë dhe ka vepruar konform kërkesave të LKK-së. Me anë të ndërhyrjes së Agjencionit është arritur shmangja nga gjendja e konfliktit të interesit.

Lidhur me një iniciativë ligjore të ndërmarre nga Ministria e Sherbimeve Publike për hartimin e “Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcionit Publik”, Departamenti ka marrë pjesë aktive në Grupin Punues Ndërmënyës për ta hartuar këtë ligj në mënyrë sa më efektive, të plotë dhe në linjë me të gjitha standardet ndërkombëtare. Projektligji pas finalizimit është aprovuar nga ana e Qeverisë dhe ndodhet aktualisht për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës.

iv. Pranimi i Dhuratave

Me qëllim rregullimin dhe krijimin e bazës ligjore për regjistrimin e dhuratave në institucionet qendrore të Kosovës, me iniciativën e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe me pjesëmarrjen edhe të AKK-së dhe institucioneve tjera perkatese është hartuar Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin e Dhuratave në Institucionet e Kosovës. Përveç udhëzimeve lidhur me mënyrën e regjistrimit të dhuratave dhe personat përgjegjës për këtë çështje, udhëzimi përmban edhe katalogun/regjistrin e dhuratave dhe me hyrjen e tij në fuqi pritet që të shpërndahet tek të gjitha institucionet përkatëse dhe të fillojnë veprimet e parashikuara nga LKK-ja. Nderkohe, Departamenti po ben nje pune per gatitore per menyren se si do ti klasifikoj dhe katalogoj regjistrat e dhuratave qe do te vijne nga institucionet qendrore ne fund te vitit si dhe per gatitjen paraprake te formes se arkivimit dhe baze se te dhenave.

v. Pjesëmarrja në takime, seminare, vizitat zyrtare dhe trajnime te ndryshme

Gjate 6 muajve te pare te vitit, Departamenti dhe anetaret e tij kane marre pjese aktivisht ne nje sere takimesh e aktivitetesh te ndryshme, te cilat iu kane dhene mundesi zyrtareve te mesojne e te trajnohen mbi aspekte te ndryshme te punes se tyre (shih tabelen e trajnimeve). Gjithashtu me poshte paraqiten iniciativat ku Departamenti ka luajtur nje rol aktiv:

- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Dhuratave.

IV. DEPARTAMENTI I SHERBIMEVE ADMINISTRATIVE

Fillimi i vitit 2007 Departamentin e Shërbimeve Administrative e ka përcjelle me një varg problemesh të natyrës së mirë funksionimit kryesisht problematike kane qene buxheti, numri i pamjaftueshem i zyrtareve, kalimi AKK-së në objekt të ri dhe i parapërgatitjes së ambienteve të përshtatshme për punë. Kjo e fundit ka kërkuar si parakusht pajisjen e AKK-së me rrjet funksional interneti, me gjenerator në rastet e mungesës së energjisë, me sigurimin e ngrohjes së ambienteve dhe punë tjera administrative. Për këto është kërkuar Ministrisë së Shërbimeve Publike një gjenerator si dhe një automjet për nevojat logjistike të AKK-së, gje që tashme është realizuar.

Gjithashtu një ndihmë e madhe për Departamentin ka qene rekrutimi i dy zyrtareve të rinj, Shefi i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme dhe Asistentes Administrative të cilët kanë rritur se tepërmi cilësinë e kryerjes së angazhimeve të ndryshme. Deri tani me Shefi i Divizionit kryen të gjitha detyrat logjistike si sigurimi i ngrohjes së ambientit, funksionimit të gjeneratorit, makinave, rrjetit elektrik dhe shërbime tjera. Asistentja Administrative megjithë ngarkesën e detyrës së saj në realizimin dhe mirëmbajtjen e protokollit, procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Agjencionit krahas tyre ka kryer e ndihmuar në realizimin e shumë detyrave të tjera si dorëzimi i pagesave në thesar (në mungesë të zyrtarit për buxhet dhe finance), dorëzimin e kërkesave në institucione dhe ndihmë ndaj dy departamenteve tjera në punët e përditshme.

i. Buxheti 6 mujor per vitin 2007

Nje vendim Nr. 02-2840-1/06 datë 23 dhjetor 2006 i Parlamentit te Kosoves i atribuon Agjensionit mjetet buxhetore ne vlerë prej 536,600.00 €. Ky vendim eshte paraqitur ne baze te linjave te buxhetit si me poshte vijon:

○ Pagat dhe mëditjet (35 zyrtare)	147,151.00 €
○ Mallra dhe Shërbime	284,649.00 €
○ Shpenzimet Kapitale	80,000.00 €
○ Shpenzimet Komunale	24,800.00 €
GJITHSEJ	536,600.00 €

Mirepo ne fillim te vitit 2007, shuma e alokuar nga Ministria e Ekonomise dhe Financave per Agjensionin ka gene ne shume 412, 952 € gje qe e ka cunuar me te padrejte buxhetin e miratuar nga Parlamenti me 23.04 % më pak.

- Agjencioni Kosovar Kundërkorrupsionit për vitin 2007 nga MEF-i ka këtë buxhet të lejuar për këto kode ekonomike :

○ Pagat dhe mëditjet (8 zyrtare)	105,600.00 €
○ Mallra dhe Shërbime	256,052.00 €
○ Shpenzimet Kapitale	40,000.00 €
○ Shpenzimet Komunale	11,300.00 €
GJITHSEJ	412,952.00 €

Pra sic shihet dhe nga shifrat e paraqitura me lart, Ministria vendos me deshiren e saj se buxheti duhet zvogëluar me 123,648.00 € dhe numri i punetoreve duhet te jete 8 nga 35 te paracaktuar.

Si pasoje e ketyre vendimeve absurde, gjate tre muajve te pare te vitit, AKK-ja pati probleme serioze ne kryerjen e pagesave për arsye të mungeses së zyrtarit per prokurim, zyrtarit për buxhet dhe financa, zyrtarit për zotim (moduli i blerjes dhe modulën e aprovimit) dhe zyrtarit për vlerësimin e pasurisë te cilet jane kyc dhe te domosdoshme për funksionimin e pagesave ne kohe. Nderkaq megjithëse eshte plotësuar vendi i zyrtarit per prokurim nuk na eshte lejuar mundesia per te pasur te tjere keshtu qe na eshte dashur te trajnojme dhe certifikojme përpos detyrave te tyre specifike zyrtare te tjere.

Duke gene se Agjensioni operonte ne nje suate absurde me 8 zyrtare, institucioni u detyrua ti drejtohej dhe njehere Ministrise se Ekonomise dhe Financave duke u mbështetur e paraqitur serish vendimin Kuvendit të Kosovës të datës 23 dhjetor 2006 nr. 02-2840-1/06, e ne kete rast nga ana e Ministrise u lejuan qe ne muajin shkurt te merreshin ne pune dhe 7 zyrtare tjerë. Aktualisht AKK-ja operon permes 15 zyrtarëve (shih Aneks I) që në fakt janë një numër shumë i vogël për te pretenduar ne nje funksionalitet te

plote te AKK-së kurse në linjat buxhetor per mallrat dhe shërbimet, shpenzimet kapitale dhe ato komunale nuk ka pasur ndryshime financiare por kanë mbetur ato që janë lejuar nga Ministria e Ekonomise dhe Financave.


Tabela me poshte tregon ne menyre te detajuar shpenzimet e buxhetit te lejuar nga Ministria e Ekonomise dhe Financave:

Nr	PERSHKRIMI	Alokimi	Shpenzimet	Zotuara	Shpenzime/ Zotuara	% e shpenzime ve	% e shpenzime ve dhe zotimeve
1	2	3	4	5	6	7	8
1	Pagat dhe mëditjet	52 800.00	21995.40	0.00	21995.40	41.66	41.66
2	Mallra dhe shërbime	18 9338.00	87302.1	23688.71	110990.81	46.11	58.62
3	Shpenzimet komunalëve	59 41.00	1613.54	464.69	2078.23	27.16	34.98
4	Investimet kapitale	40 000.00	0.00	40000.00	40000.00	0.00	0.00
	GJITHSEJ	280,079.00	110,911.04	64,153.40	175,064.44	38.50	60.77

Sic mund te vihet re nga mosrealizimi i buxhetit në kufijte e planifikuar të rrjedhës së parasë për gjashtëmuorin e parë të vitit 2007 një nder shkaqet kryesore ka qenë mungesa e zyrtarit per prokurim dhe zyrtarit për zotimin e mjeteve në modulën e blerjes dhe aprovimit, gje qe u reflektua haptazi sic u përmend dhe me lart ne funksionimin e Agjensionit ne tre muajt e pare.

Ndersa zotimet e mjeteve kapitale janë në përfundim e siper e së shpejti do kryhen.

Gjithashtu, për shkak se ne fillim te vitit jemi vendosur ne nje objekt të ri privat i dhene me qera faturat e shpenzimeve komunaleve kanë ardhur me vonese mirepo pritet qe dhe ky sherbim te permiresohet ne muajt ne vijim.



Disa shpenzime sipas kodeve ekonomike

PERSHKRIMI	Muaji	Shuma	Gjithsej
<i>Trajnimi i Stafit</i>	5	2,200.48	2,200.48
<i>Shërbimet Komunale</i>	5	1,613.54	1,613.54
<i>Telefoni</i>	5	1,867.08	1,867.08
<i>Shërbime+ pagesat e këshillit</i>	13	8,468.30	8,468.30
<i>Pajisjet</i>	6	23,879.62	23,879.62
<i>Furnizime</i>	6	3,398.52	3,398.52
<i>Karburante për nxehe dhe auto.</i>	5	2,436.87	2,436.87
<i>Shpenzimet e sigurimit të objektit</i>	3	3,409.29	3,409.29
<i>Mirëmbajtja e objektit</i>	3	1,860.00	1,860.00
<i>Qiraja e ndërtesës</i>	4	15,200.00	15,200.00
<i>Shpalljet dhe reklamat</i>	6	6,846.65	6,846.65
GJITHSEJ		71,180.35	71,180.35

ii. Burimet Njerezore

Divizioni i Burimeve Njerezore dhe Perkthimit (shih Aneksin I) është pjesë e rëndësishme e Departamentit të Shërbimeve Administrative. Gjatë 6 muajve të parë të vitit e deri tani Divizioni ka funksionuar vetëm me një zyrtar, çfarë ka penguar në të shumtën e rasteve performancën e duhur të divizionit. Megjithatë

pengesat e parashtruara divizioni eshte fokusuar dhe ka bere nje pune te kënaqshme ne aspektin e trajtimit ne kohe dhe me efikasitet te:

- Hapjes se vendeve te reja te punes dhe kryerjes se procedurave transparente per punësimin e zyrtareve te rinj; dhe
- Krijimin e nje plani trajnimesh per aftësimin e zyrtareve te Agjencionit.

Tabela e mëposhtme tregon me hollesi dhe ne menyre kronologjike trajnimet e kryera dhe fushat perkatese. Duhet theksuar se trajnimet kane qene rezultative dhe te gjithë zyrtaret e Agjencionit jane përpjekur qe eksperiencat e përfutuara prej tyre ti vene ne veprim per te rritur performances dhe cilesine e detyrave te tyre.

Gjithsesi nuk mohohet nevoja e trajnimeve te mëtejshme e te specializuara ne fusha te ndryshme meqenëse Agjencioni eshte nje institucion i perbere nga njerëz pa shume pervoje ne kete fushe te re.

Nr	Emri & Mbiemri	Lloji i Trajnimit	Organizimi nga	Vendi	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.	Xhevat Bekteshi	Zotues	MEF-i	Prishtinë, Kosove	10.01.2007	15.01.2007
2.	Sebahte Jonuzi	Moduli i Blerjes	MEF-i	Prishtinë, Kosove	11.02.2007	16.02.2007
3.	Sebahate Jonuzi	Prokurim	KRPP-ja	Prishtinë, Kosove	10.01.2007	15.01.2007
4.	Hasan Preteni	Avancimi i qeverisjes së mire dhe lufta kundërkorrupsionit	Banka Botërore Qeveri Belge OECD-ja	Bruksel, Belgjike	14.03.2007	15.03.2007
5. 6. 7. 8.	Xhemajl Buzuku Sebahate Jonuzi Enver Krasniqi Mimoza Limani	Prokurim	KRPP	Prishtine, Kosove	25.03.2007	
9. 10. 11.	Mefail Bajqinovci Mentor Borovci Enver Krasniqi	Mediat dhe menaxhimi i krizave	UNDP OSCE	Prishtine, Kosove	Mars 2007	
12.	Hasan Preteni	Përvojat e mësuara në parandalimin e korrupsionit	OSBE-ja dhe Pakti i stabilitetit	Tiranë, Shqiperi	03.04.2007	04.04.2007
13.	Hasan Preteni	Transparenca kundërkorrupsioni dhe etika në edukim	UNESCO	Ohër, Maqedoni	25.04.2007	27.04.2007
14.	Mentor Borovci	Udhëtim studimor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit	OSBE-ja AKK-ja	Tiranë, Shqiperi	21.05.2007	23.04.2007

15.	Enver Krasniqi	dhe Kontrollit të Pasurive				
16.	Jeton Qarri	Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin	KEC-i	Prishtinë, Kosove	28.05.2007	29.05.2007
17.	Sefer Goxhuli					
18.	Mimoza Limani	Fuqizimi dhe aftësimi i luftimit të korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë	EAR-i	Prishtinë, Kosove	30.05.2007	30.05.2007
19.	Sebahate Jonuzi					
20.	Muharrem Mustafa	Parandalimi i pastrimit të parave	FIC-i	Vushtrri, Kosove	31.05.2007	03.06.2007
21.	Enver Krasniqi	Seminar		Durres, Shqiperi	31.05.2007	03.06.2007
22.	Jeton Qarri	Seminar mbi Teknikat e Hetimit Financiar	Zyra e Ambasades Amerikane	Vushtrri, Kosove	04.06.2007	09.06.2007
23.	Hasan Preteni	Vizite studimore ne Zyren e Parandalimit dhe Luftimit te Korrupsionit	TAIEX Zyra Letoneze	Riga, Letoni	25.06.2007	28.06.2007
24.	Mentor Borovci					
25.	Muharrem Mustafa					
26.	Mimoza Limani	Pastrimi i parave dhe korrupsioni	Instituti Gjyqesor i Kosoves	Prishtine, Kosove	05.07.2007	05.07.2007

V. ZYRA PER MARREDHENIE ME PUBLIKUN

Zyra per Marredhenie me Publikun, nga momenti i emerimit ne pune te zyrtarit te saj ne Mars 2007 e ka perqendruar punen kryesisht ne keto aspekte:

- Takime me gazetarë dhe qytetarë;
- Faqja e re zyrtare e internetit;
- Deklaratat per shtyp; dhe
- Monitorimi i mediave per periudhen janar – qershor 2007;
- Aktivitete dhe bashkepunimi

i. Takime me gazetarë dhe qytetarë

Gjate gjithë periudhes se funksionimit te Agjensionit ka pasur nje interesim te madh si nga ana e komunitetit te gazetareve por edhe nga ana e publikut persa i perket iniciativave dhe aktiviteteve te Agjensionit, ku nuk kane munguar dhe interesimi per te bashkëpunuar ngushtësisht per parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni ne shoqerine kosovare.

Gazetare sikundër dhe qytetare te thjeshte gjate ketyre 6 muajve kane trokitur shpesh ne deren e institucionet me qellim per te marre informacione e te dhena te detajuara se si mund ta ndihmojne Agjensionin apo bashkepunojne me te. Zyrtaret e Agjensionit kane qene gjithmonë te gatshem e iu kane ofruar asistencë te specializuar dhe bashkëpunim ne rastet kur ka pasur dyshime te bazuara per raste korruptive.

ii. Faqja e re zyrtare e internetit

Ne kuadrin e nje projekti dhe nisme te perbashket me Organizaten per Siguri dhe Bashkepunim ne Evrope (OSCE) gjate muajve qershor dhe korrik 2007 eshte punuar ngushtësisht dhe intensivisht ne konceptualizimin dhe finalizimin e nje faqe te re zyrtare interneti per Agjensionin.

Kjo faqe e re do te jete per publikun e gjere dhe do te kete nje informacion te larmishem mbi aktivitetet, detyrat dhe iniciativat e ndërmarra nga Agjensionin. Te gjithë te interesuarit te cilet do te perdorin kete faqe do te keni mundesi te marrin informacion per aktivitete te cilat jane ne zhvillim e siper, ato qe jane mbajtur me përpara e cilat do te mbahen ne te ardhmen, permes nje përshkrimi shume profesional te detajuar dhe ne kohe reale. Pritet qe faqja te jete funksionale dhe e përdorshme prej publikut duke filluar nga muaji Gusht 2007.

Ne kete kontekst duhet përmendur fakti se ne bashkëpunim me Organizaten per Siguri dhe Bashkepunim ne Evrope (OSCE) dhe Programin e Zhvillimit te Kombeve te Bashkuara (UNDP) gjate ketyre muajve te fundit eshte punuar intensivisht per përgatitjet e nje fushate kombetare ndergjegjesimi publik mbi punen e Agjensionit Kosovar kunder Korrupsionit dhe luften kunder korrupsionit. Shpallja e fazes se pare te fushates do te kryhet me 29 Gusht 2007 dhe do te vazhdoje per 3 jave, ndersa faza e dyte do te kryhet gjate muajit dhjetor.

iii. Deklaratat per shtyp

Gjate ketyre 6 muajve te pare te vitit, Zyra e Marredhenieve me Publikun ka luajtur nje rol te rëndesishem ne berjen publike dhe sigurimin e shpërndarjes ne te gjithë median e shkruar dhe elektronike te komunikates per shtyp mbi rezultatet e deklarimit te pasurise te zyrtareve te larte.

Dy deklarata per shtyp te datave 10 prill 200 dhe 7 maj 2007 kane pasur shume jehone si ne median e shkruar dhe ate vizive ne paraqitjen e gjendjes se sakte mbi deklarimet e kryera nga zyrtaret e larte neper institucionet qendrore.

Gjithashtu, Zyra per Marredhenie me Publikun ne cdo moment ka qene e gatshme per tju përgjigjur ne menyre profesionale kërkesave te ndryshme qe vijne nga gazetare apo media mbi iniciativat ose detyrat e Agjensionit.

iv. Monitorimi i mediave ne periudhen janar - qershor '07

Sipas asaj qe është shkruar për AKK del se mediat mbi 98% kanë shkruar pozitivisht. Për punën dhe ta arriturat është shkruar gjerësisht dhe gjithmonë mediat i kanë dedikuar hapësirën e duhur AKK-së për punën në luftën kundër korrupsionit.

Muaji	Media të cilat kanë raportuar rastet korruptive	Nr. i shkrimeve për korrupsionin
Mars	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	14
Prill	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	16
Maj	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	17
Qershor	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	24

Lista e mëposhtme paraqet ne menyre te detajuar dhe kronologjike shkrimet ne median e shkruar ne lidhje me aktivitetet e Agjensionit dhe/ose shkrimet investigative per ceshtje qe kane lidhje me fenomenin korrupsion.

Janar 2007

- 26 shkrime kryesisht për raste korruptive ku, gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike;
- Komuna e Prishtines ka qene ne shenjester te akuzave per afera korruptive po ashtu ministritë janë akuzuar për korrupsion;

- Auditimet gjenerale kanë hasue në keqpërdorime nëpër komuna dhe të gjitha ministrinë, si dhe organizata COHU ka akuzuar Zevendes Kryeministrin dhe 5 ministra për marrje pjese ne afere korruptive, me specifikisht per parregullsitë në tendera nëpër ministri e sidomos në Ministrine e Drejtësisë, në dogana, PTK dhe shumë institucione tjera.

Shkurt 2007

- 16 shkrime për raste korruptive nga institucionet publike;
- Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë më me dyshime për korrupsion AKM, po ashtu edhe me keqpërdorime në tenderët e komunave;
- Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afere korruptive nëpër spitale dhe PTK.

Mars 2007

- 4 shkrime të cilat kanë paraqitur ekskluzivisht Agjensionit dhe punen e kryer prej tij;
- Eshhte trajtuar ceshtja e deklarimeve te pasurive dhe nese do të përfundojë si duhet apo jo.

Prill 2007

- 16 shkrime për Agjensionin dhe veprimtarine e tij;
- Pas komunikatës nga Agjensioni për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuar rreth deklarimit të pasurive dhe mosdeklarimi i pasurive të ministrave dhe të gjithë zyrtarëve në detyra publike.
- Shkrimet kanë qenë kryesisht kritike ndaj qeveritarëve te cilet nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë së tyre.

Maj 2007

- Gjithsej 13 artikuj në gazeta;
- Tri shkrime kanë qenë kritike për punën e AKK-së. OJQ "Çohu" ka akuzuar agjensionin antikorrupsion për fshehjen e pasurive të politikanëve ndersa Gazeta Epoka e Re ka akuzuar Agjensionin për konflikt interesi brenda Agjensionit;
- Pas komunikatës së dytë nga Agjensioni, ku përmenden emrat e atyre që nuk e kanë bërë deklarimin e pasurive, shumica e shkrimeve kanë qenë të fokusura në emrat e personave zyrtarë që nuk e kanë bërë deklarimin e pasurive dhe kanë bërë presion për ta kryer këtë detyrë.

Qershor 2007

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 10 shkrime mjaft positive për AKK-në;
- Mediati elektronike dhe ato të shkruara, kanë informuar publikun se AKK-ja për tre muajt e parë të këtij viti i ka kthyer buxhetit 300 mije euro dhe janë arrestuar disa persona zyrtarë;
- Shkrimet kanë hedhur idenë për ndryshimin e ligjit të AKK-së, për bërjen publike të pasurisë së zyrtarëve të lartë;
- Gazeta Epoka e Re, ka bërë publike harxhimet e karburanteve për institucionet publike, ku AKK-ja zë vendin e fundit në këtë listë sa i përket harxhimeve minimale;

- Po ashtu në Infopress i është dhënë hapësirë e madhe punës së AKK në kthimin e 300 mijë euro para të keqpërdorura buxhetit të Kosovës.

v. Aktivitete dhe bashkëpunimi

Sic u përshkrua dhe me lart bashkëpunimi me Organizaten për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në kuadrin e projektit të ndërgjegjesimit të gjere të publikut mbi punën e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit dhe luftën kundër korrupsionit një seminar me titull "Roli i mediave në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit" u zhvilluar në datën 27 qershor 2007.

Gjate këtij seminari janë diskutuar format e bashkëpunimit me gazetarë hulumtues që merren me fushën e korrupsionit, janë trajtuar ceshtje të kuadrit ligjor dhe mekanizmave në luftën kundër korrupsionit në vend, janë shtjelluar dhe diskutuar kompetencat e AKK-së, paraqitur aktivitete dhe arritje të ndryshme, etj. Gjate diskutimeve në këte aktivitet është kërkuar me ngulm nga ana e gazetarëve se Agjencioni duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që projekt ligji i ri për deklarimin e pasurive të këte si pjesë perberese dhe bëjëjen transparente të deklarimeve.

VI. PROBLEMET E NDESHURA

Megjithë përpjekjet e mëdha dhe të vazhdueshme të Agjencionit për të funksionuar normalisht dhe në kushte problematike gjate 6 muajve të parë të vitit 2007, institucioni ia ka dalë mbanë të kryejë një larmishmeri detyrash dhe aktiviteteve. Gjithsesi nuk kanë munguar dhe përballja me probleme të ndryshme të cilat shtjellohen me poshte:

- Problemet e krijuara në mirë menaxhimin e Agjencionit nga cungimi i padrejte i buxhetit të vitit 2007;
- Mospërfunksionimi me numrin e duhur të zyrtarëve, po vetëm me 40 përqind të kapacitetit të burimeve njerezore gje që ka çuar në mungesa të theksuara në mbarëvajtjen e punëve dhe kryerjen e detyrave perkatese;
- Niveli shumë i ulët i pagës së ofruar dhe aspak motivues;
- Pamundësia e angazhimit të ekspertëve dhe zyrtarëve me përvojë në rastet e parashikuara në kornizën ligjore;
- Të gjitha kërkesat për stimulim dhe rrezikshmëri drejtuar organit përkatës deri tani janë refuzuar dhe skane gjetur zgjidhje;
- Mospërputhje e nivelit të pagave të Agjencionit me institucione të tjera të pavarura dhe me të njëjtën rrezikshmëri pune;
- Bashkëpunimi institucional ka caluar dhe mbeshtetja nga ana e institucioneve kryesore ka munguar;

- Mungesa e trajnimeve specifike dhe e asistences teknike te fokusuar ne ceshtjet qe trajton Agjensioni; dhe
- Nje kornize ligjore e cila ka nevojte te menjehershme per ri-formulim, permiresim dhe plotesim.

VII. SFIDAT E SË ARDHMES

Për realizimin e misionit në bazë të LKK-së por edhe për realizimin e detyrave tjera shtesë që do të dalin nga ligjet që ne proces hartimi, shqyrtimi apo dhe aprovimi, AKK-ja parashikon se cilat do të jene disa nga sfidat me te cilat do te perballtet ne muajt ne vijim:

- Buxheti i AKK-së për vitin 2007 të disbursohet sipas vendimit të Kuvendit, Nr. 02-2840-1/06 datë 23 dhjetor 2006 brenda fundit te vitit;
- Buxheti i AKK-së për vitin 2008 të mos ndeshi të njëjtat probleme të hasura deri tanimë;
- Te behet e mundur pajisja me stafin e nevojshme prej 35 vetash dhe te mundesohen trajnime te specializuara per ta;
- Zyrtarëve të AKK-së ti mundësohet kompensimi për rrezikshmëri në punë;
- Zyrtarët e AKK-së të kenë status të veçantë dhe te trajtohen jo si shërbyesit e tjere civil;
- Te behet e qarte se cilit organ (Qeverisë apo Kuvendit) Agjensioni duhet ti drejtohen për çështjet e buxhetit dhe ceshtje te tjera paresore;
- Te hartohet dhe te vihet ne zbatim se bashku me partneret e tjere kryesor nje Strategji dhe Plan Veprimi i ri per vitet 2008-2010, ne nivel qendror dhe ate lokal.
- Te kryhen amendimet e Ligjit kunder Korrupsionit dhe keto ndryshime te vihen ne zbatim ne menyre korrekte dhe te synojne rritjen e mbare vajtjes se Agjensionit;
- Te zbatohet ne menyre korrekte dhe te pershtatshme Ligji per Parandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe te behet i mundur krijimi i mekanizmave te pershtatshem per zbatimin e kornizes ligjore dhe parandalimit te konfliktit te interesave ne institucionet publike; dhe
- Te jepet asistence e duhur dhe profesionale ne hartimin e Ligjit per Deklarimin e Pasurive ku fokusi te pergendrohen dhe ne mundesimin e kontrollit te tyre dhe berjen publike te deklarimeve si dy pjese te rendesishme perberese te nje ligji ne linje me instrumentat nderkombetare.

VIII. ANEKS I – ORGANIGRAMA E PERDITESUAR E AGJENSIONIT

